


R E L A C I O N: "Rikonstruktion dhe ndërtim rrjet ujësjellësi , Rr. Migjeni "

1. Qëllimi

Ky projekt zbatimi konsiston në rikonstruksionin dhe ndërtimin e disa linjave të reja të furnizimit me ujë si rezultat i ndërtimit të një rruge te re në zonën e Yzberishtit- Njësia Administrative Kashar.

2. Vëndndodhja

Rruga e re "Migjeni" që është në fazë ndërtimi ndodhet midis zonës së Yzberishtit dhe Unazës së re, Njësia Administrative Kashar, pra do të bëjë të mundur lidhjen e këtyre dy zonave.





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 42240978
info@ukt.al
NIPT J620050020


3. Gjendja e infrastruktures ekzistuese.

Gjatë ndërtimit të rrugës së re "Migjeni", në Yzberisht , investim ky i realizuar nga Bashkia Tiranë, gjatë punimeve kanë dalë në sipërfaqe disa tuba që furnizojnë me ujë këtë zonë.

Tubat me dimension PE100PN10 Dj-250 mm, PE100PN10 Dj-140 mm, PE100PN10 Dj-125 mm, PE100PN10 Dj-110 mm etj duhet të spostohen në hapsira të lira dhe të jenë të aksesueshme nga punonjësit e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Tiranë për çdo defekt që ato mund të paraqesin ndër vite.

Rikonstruksioni dhe spostimi duhet të bëhet në mënyrë urgjente në kohë për të shmangur probleme në cilësinë e tubacioneve ndaj kushteve atmosferike si dhe në cilësinë e ujit që ato përcjellin.

Planimetria e gjëndjes aktuale.





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 42240978
info@ukt.al
NIPT J620050020

Pamje aktuale.





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 42240978
info@ukt.al
NIPT J620050020



Disa nga lidhjet e realizuara në terren nuk janë të pajisura me saracineske dhe matesa bilanci.

Gjithashtu rikonstruksioni dhe spostimi i tubacioneve kërkon ndërtimin e pushtave të reja sëbashku me aksesorët e nevojshëm pasi ato aktualisht janë jashtë funksionit.

4. Rilevimi topografik i zonës

Rilevimi topografik i zonës për hartimin e këtij projekt zbatimi është bërë duke u mbështetur në dokumentet e arshivës së Sektorit të Projektimit të sh.a. U.K.T. si dhe matjet topografike të bëra në terren.

5. Llogaritjet Hidraulike të Rrjetit të ri të Ujësjetellësit

Me rikonstruksionin dhe spostimin e rrjetit aktual disa prej objekteve shumëkateshe që ndodhen në anën e djathtë të rrugës mbeten pa ujë. Për këtë duke u mbështetur në numrin e popullsisë dhe duke menduar që është një zonë në perspektivë për tu populluar duke ndërtuar objekte të reja, gjithashtu duke u mbështetur në normen e furnizimit me ujë $n=150$ l/(banorë*ditë), orarin e furnizimit me ujë ku kjo zonë furnizohet rreth 13 orë në ditë del se është e nevojshme ndërtimi i një linje me dimension Pe100Pn10 Dj-250mm. Ky tubacion do të lidhet me tubin Pe100Pn10 Dj-160mm që aktualisht Bashkia Tiranës ka shtruar në këtë zonë.

Projektuese
Ing. Anisa ZAKA

Përgj/Sektori Projektimi
Ing. Albana MILO